



KUVENDI KOMUNAL PEJË

I. Numër:463-01/46796,datë:30. Qershor 2020.

Në bazë të dispozitave të nenit 11 dhe 12 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale të Republikës së Kosovës dhe në mbështetje të nenit 24 dhe 25 të Ligjit mbi dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës Ligji Nr. 06/L-092, si dhe nenit 36 të Statutit të Komunës së Pejës, 01. Nr.09-8103 dt. 29.09.2008 , pasi shqyrtoj propozimin e Kryetarit të Komunës për miratim paraprak për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën private të pronarit “Troja CO”. Sh.p.k. nga Peja, me rekomandim të Komitetit për Politik dhe Financa, Kuvendi Komunal në seancën e mbajtur me dt. 30. Qershor 2020, muarr:

V E N D I M

Nr. 30/2020

MBI MIRATIMIN E PROPOZIMIT TË KRYETARIT TË KOMUNËS PËR KËMBIM TË PRONËS SË PALUAJTËSHME KOMUNALE ME PRONËN PRIVATE PËR REALIZIMIN E PLANIT RREGULLUES URBAN “QËNDRA, KAPESHNICA, PUHOVCI” NË PEJË

I. MIRATOHET propozimi i Kryetarit të Komunës për këmbimin e pronës së paluajtshme komunale me pronën e personit fizik , e më qellim të Rregullimit të rrugës për Shtegun e ecjes buzë Lumit “Lumbardhë” sipas Planit Rregullues Urban “Qendra, Kapeshnica dhe Puhovci” në Pejë .

II. Për realizimin e këtij këmbimi sipas këtij Vendimi është propozuar që të zhvillohen procedurat e nevojshme ligjore për këmbimin e pronës private dhe pronës së Komunës për interes publik rregullimin e rrugës **Shtegut të Ecjes buzë lumit Lumbardhë sipas Planit Rregullues Urban “Qendra, Kapeshnica dhe Karagaqi” në Pejë, për realizimin e këtij interesi publik Pronarit privat “TROJA CO” SH.P.K. nga Peja** për pronën private e cila gjendet në ngastrën 2959/1 në sipërfaqe prej 67 m² ZK Pejë me ½ dhe objektit individual për banim me etazhitet që gjendet në këtë ngastër në këmbim me pronën komunale 5738/2 në sipërfaqe prej 385 m², 5738/3 në sipërfaqe prej 207 m² ZK Pejë gjithsejt 592 m², ndërsa vlerësimin ligjor do ta bëjë Zyrja për Vlerësimin e Pronës së Paluajtshme në kuadër të Ministrisë për Financa.

III. Pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi, Komuna në afat prej pesë ditëve e paraqet kërkesën për vlerësimin e pronave të paluajtshme sipas pikës II të këtij vendimi Zyrës për Vlerësimin e pronës së Paluajtshme pran Departamentit të Tatimit në Pronë në kuadër të Ministrisë së Financave.

IV. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit në Ministrinë e Administrimit të Pushtetit Lokal si dhe 7 ditë pas publikimit në ueb faqen zyrtare të Komunës.

Vendimi ti dërgohet:

- 1x1 MAPL-së
- 1x1 Kryetarit të Komunes
- 1x1 DÇPJ
- 1x1 Arkivë.



KRYESUESI I KUVENDIT

Dr. Islam Husaj